



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/45/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Xh. M përmes mbrojtësit së tij av. K. K, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A. I, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 23.01.2023 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga Xh. M përmes mbrojtësit së tij av. K. K ndaj gjyqtarit A. I për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi Xh.M përmes mbrojtësit të tij av. K. K ka ushtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit A. I në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Sipas parashtruesit të ankesës, arsyeja që po i drejtohet KGJK-se, është fakti se vendosja për ankesën nga ana e Kryetares së Gjykatës Themelore të Prishtinës, do të ishte negative duke u bazuar në faktin se e njëjta ka refuzuar kërkesën për përjashtim të gjyqtarit në të njëjtën çështje penale, andaj konsideron se ka bazë të mjaftueshme për përjashtim nga vendosja në këtë çështje penale.

Kryesuesi i Këshilli Gjyqësor të Kosovës, pas shqyrtimit të kërkesës së mbrojtësit Kërveshi, me datë 29.12.2022, përmes aktit përcjellës me numër të referencës 01/1977, ankesën e ka deleguar në kompetencë tek Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që e njëjta ankesën në fjalë ta trajtoj konform Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ankesa disiplinore në Gjykatën Themelore në Prishtinë është pranuar me datë 30.12.2022, të njëjtën ditë është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruesit.

Parashtruesi i ankesës Xh.M përmes mbrojtësit të tij av. K. K ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit A. I për shkak të pretendimeve se gjyqtari A. I si kryetar i trupit gjykues për të mitur në çështjen penale me numër PM.nr.170/19 me datë 18.10.2021, ka nxjerr aktgjykimin me të cilin e shpall fajtor të pandehurin Xh.M për veprën penale Keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 198 par.5, nën paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 të KPK-së, përkundër se nga muaji prill 2019 ka hyrë në fuqi Kodi i ri Penal, me të cilin kod nuk parashihet vepra penale

“Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare” si vepër penale dhe sipas parimit të zbatimit të ligjit më të favorshëm për palën, i pandehuri Xh.M është dashtë të lirohet nga akuza për kryerjen e kësaj veprë penale për shkakun se nuk parashihet më si vepër penale.

Më tej në ankesë parashtruesi ka theksuar se fakti që vepra penale për të cilën shpallet fajtor i akuzuari Xh.M, nuk parashihet me kodin e ri penal e thekson edhe gjyqtari në arsyetim të aktgjykimit, ku thekson: vepra penale Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare nga neni 198 paragrafi 5 nën paragrafi 6 lidhur me paragrafin 2 të KPK, sipas ligjit i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale korrespondon në thelb me veprën penale Sulm Seksual sipas nenit 229 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 nën paragrafi 3.10 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili është në fuqi tani në kohën e procedurës. Tutje në ankesën e tij parashtruesi ka theksuar se togfjalëshi që e përdor gjyqtari “korrespondon në thelb”, shkel njërin nga parimet bazë të së drejtës penale, atë të ligjshmërisë duke rënë ndesh me nenin 3 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili përcakton “Përkufizimi i një veprë penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i një veprë penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.

Po ashtu parashtruesi është ankuar edhe për anshmëri të gjyqtarit nga pala e dëmtuar, duke shtuar se faktet në të cilat ai e mbështet anshmërinë e gjyqtarit, janë vet thëniet e kryetarit të trupit gjykues të përdorura në aktgjykimin e datës 15.11.2021, dhe të njëjtat kuptohen nga mënyra e të shprehurit në aktgjykim ku shihet se ka tendencë për të arsyetuar me çdo kusht “fajësinë” e të pandehurit dhe se gjyqtari i tejkalon kompetencat e tij si gjyqtar dhe në disa raste në argumentimet e tij shfaqet në rolin e avokatit të palës së dëmtuar apo edhe të prokurorisë. Në fund të ankesës së tij, parashtruesi ka theksuar se të pandehurit janë duke iu shkaktuar dëme të pariparueshme me zvarritjen e kësaj procedure gjyqësore.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtari A. I ka deklaruar se, mbrojtësi i të pandehurit Xh.M, av. K. K asnjëherë më parë lidhur me këtë rast nuk ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore ndaj kryetarit të trupit gjykues për të mitur. Ai ishte i njoftuar edhe më parë me të gjitha këto pretendime por nuk kishte inicuar procedurë të tillë. Ka shtuar se, mbrojtësi i të pandehurit av. K. K pretendon për zvarritje të procedurës penale në dëm të mbrojturit të tij, ndërsa veprimet e ndërmarra nga vet mbrojtja nuk paraqesin asgjë më pak sesa pengesa procedurale në mënyrë që të realizohet pikërisht zvarritja e procedurës.

Tutje në deklaratën e tij gjyqtari A. I ka theksuar se, mbrojtja në mënyrë abstrakte përpiqet të ngritë pretendime mbi fakte të paqena lidhur me mungesën e pavarësisë dhe objektivitetit. Vendimet gjyqësore në këtë çështje penale merren nga trupi gjykues që është organ kolegjal e jo nga kryetari i trupit gjykues. Prandaj është jashtë çdo racionaliteti që pasi të shfrytëzohen të gjitha mjetet juridike ku të gjitha rezultojnë të pasuksesshme të ngritën pretendime për shkelje disiplinore ndaj njërit gjyqtar pa asnjë arsye të vlefshme juridike. Ka shtuar se, asnjëherë nuk e ka takuar as palën e dëmtuar e as palën e akuzuar, as ai e as familjarët e tij, hera e parë që i ka takuar ka qenë gjatë seancave gjyqësore. Rrjedhimisht, pretendimi se qëllimisht, është vepruar në disfavor të palës së akuzuar është i pabazuar. Më tej në deklaratën e tij gjyqtari ka theksuar se kjo kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore është bërë pasi mbrojtja është njoftuar se është caktuar seanca e shqyrtimit gjyqësor ngase organi kompetent kishte refuzuar kërkesën për përjashtim. Tutje në deklaratën e tij gjyqtari ka theksuar se, sa i përket pretendimeve lidhur me Aktgjykimin e shkallës së parë, duke qenë se ai është kryetar i trupit gjykues e ka të pamundur juridikisht të jap mendim sepse është i kufizuar në komentimin e vendimeve gjyqësore, sidomos

kur ato janë vendime kolegjiale. Ka shtuar se, vendimet gjyqësore parimisht i nënshtrohen vlerësimeve dhe janë objekt shqyrtimi nga instancat tjera gjyqësore. Tutje ka theksuar se, Gjykata e Apelit nuk ka dhënë asnjë vërejtje në mbështetje të pretendimeve të mbrojtjes, aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar sërish sikurse siç ishte anuluar edhe më parë kur lënda ishte tek një trup tjetër gjyqësor për arsyet të cilat janë theksuar në aktvendimet e Gjykatës së Apelit por nuk kanë të bëjnë asgjë me pretendimet e mbrojtjes.

Në fund të deklaratës së tij, gjyqtari ka propozuar që kërkesa e mbrojtjes për fillimin e procedurës disiplinore të refuzohet.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A. I lidhur me procedurën e zhvilluar dhe aktvendimit të marrë në lëndën PM.nr.170/19 (2019:156690), për të cilën parashtruesi është ankuar.

Nga pretendimet e palës ankuese Autoriteti kompetent i kësaj Gjykate vlerëson se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: njëanshmëri të gjyqtarit dhe vendimi jo të drejtë për shkak të gjuhës së përdorur në aktgjykimin PM.nr.170/19 të datës 15.11.2021.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit se gjyqtari A. I ka përdorur gjuhë të papranueshme në arsyetim të aktgjykimit dhe ka shpallë aktgjykim dënues për të pandehurin në këtë çështje, rrjedhimisht me këto veprime ka qenë i njëanshëm, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vë në pah se nuk e ka të drejtën e komentimit të vendimit të marrë nga gjykata përkatësisht nga trupi gjykues për të mitur, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ceket: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate gjen se për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore. Për më tepër, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vëren se, Gjykata e Apelit me aktvendimin PARK.nr.7/2022 të datës 16.02.2022, i ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit sa i përket kualifikimit të veprës penale dhe shprehjeve të përdoruara në arsyetimin e aktgjykimit PM.nr.170/2019 nga ana e gjyqtarit, dhe çështjen penale në fjalë e ka kthyer në rigjykim, duke i theksuar shkeljet esenciale që i përmban aktgjykimi dhe udhëzimet se si të veprojnë në rigjykim shkalla e parë.

Lidhur me pretendimin ankimor se ka pasur zvarritje në këtë çështje penale, pas shikimit të shkresave të lëndës është gjet se nuk qëndron ky pretendim ankimor sepse pas kthimit të lëndës në rigjykim nga Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore ka caktuar seancë me datë 23.06.2022, 07.10.2022 dhe 14.11.2022, të cilat seanca janë shtyre për shkak të mungesës së palëve në

procedurë si dhe për shkak të propozimeve të palëve, andaj duke i pasur parasysh këto rrethana, Autoriteti i kësaj gjykate konsideron se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari A. I ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/45/22, me datë 23.01.2023

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë